

ANEKSI C: Si të bëni një ankesë në lidhje me problemet në Qendrat e Largimit të Imigracionit (IRC), Qendrat e Ndalimit Afatshkurtër (rSTHFs) dhe gjatë shoqërimit

HYRJE

Ju lutemi lexoni këto Shënime Udhëzuese përpara se të plotësoni formularin e ankesës.

Ky formular shërben për ankesat brenda qendrës së largimit të imigracionit, përfshirë edhe gjatë shoqërimit. Një udhëzues i veçantë ku shpjegohen procedurat më të gjera të trajtimit të ankesave nga Zyra e Brendshme (Vizat dhe Imigracioni në Mbretërinë e Bashkuar, Autoriteti për Zbatimin e Ligjit për Imigracionin, Forcat e Kufirit) mund të gjendet në adresën:

<https://www.gov.uk/government/publications/complaints-management-guidance-version-7>.

Për t'ju ardhur në ndihmë, këto shënime dhe formularët e ankesës janë të disponueshëm në gjuhë të ndryshme, por nëse ankesa juaj është shkruar në një gjuhë të ndryshme nga anglishtja, ajo duhet të përkthehet. Kjo mund të na marrë më shumë kohë për t'ju dhënë një përgjigje.

Për të hetuar ankesën tuaj, mund të jetë e nevojshme që t'ju intervistojnë. Në rast se jeni të shqetësuar për këtë, ju lutemi flisni me një anëtar të personelit. Ankesa juaj mund të mos shqyrtohet nëse nuk e ndihmoni ose bashkëpunoni me hetimin.

Bërja e një ankese nuk do të ndikojë në mënyrën se si trajtoheni në qendrën e ndalimit, nuk do të ndikojë negativisht në asnjë vendim në lidhje me statusin tuaj të imigracionit, dhe nuk do të vonojë asnjë vendim për pranimin ose largimin tuaj nga Mbretëria e Bashkuar.

SI TË BËNI NJË ANKESË

Sapo të ndodhë incidenti. Kjo do të ndihmojë në përshpejtimin e shqyrtimit të hershëm të shqetësimeve tuaja.

Fillimisht flisni me personelin lokal për të parë nëse çështja mund të zgjidhet shpejt dhe në nivel lokal. Gjithsesi, ankesa juaj do të regjistrohet. Por nëse dëshironi të bëni një ankesë zyrtare, ju lutemi përdorni formularin e ankesave bashkëngjitur (faqet 3 dhe 4).

Ankesa juaj duhet të bëhet brenda tre muajve nga data kur ka ndodhur incidenti, ankesat e marra pas kësaj periudhe mund të mos pranohen përveç rastit kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme.

KUR PËRDORET KY FORMULAR

Ankesat për ofrimin / disponueshmërinë e shërbimeve, trajtimin tuaj, çështjet e personelit, etj. gjatë qëndrimit në qendrat e imigracionit ose gjatë udhëtimit të shoqëruar, duhen bërë duke përdorur këtë formular.

Çdo ankesë, në të cilën ngrihet një pretendim për sjellje kriminale, do t'i referohet policisë. Është

zgjedhja juaj nëse doni të flisni vetë me policinë dhe personeli i zonës mund t'ju ndihmojë ta bëni këtë. Nëse dëshironi t'i drejtoheni vetë policisë, duhet të kontaktoni forcat e policisë, të cilat janë përgjegjëse për vendndodhjen gjeografike ku ka ndodhur incidenti. Faqja e internetit e Zyrës së Pavarur për Sjelljen e Policisë (IOPC) ofron informacion të dobishëm për mënyrën se si bëhen dhe trajtohen ankesat:

www.policeconduct.gov.uk/complaints/submit-a-complaint

DORËZIMI I ANKESËS

Kur bëni një ankesë, ju lutemi jepni sa më shumë informacion të jetë e mundur për atë që ka ndodhur. Në këtë ankesë duhet të përfshini datat/orët, vendndodhjen, emrat e personave të pranishëm etj, kur ato dihen. Ne do t'ju kontaktojmë në rast se kemi nevojë për më shumë informacion.

Pasi të keni plotësuar formularin, vendosni firmën dhe datën në faqet 3 dhe 4, mbani faqet 1 dhe 2 për informacionin tuaj dhe hidheni formularin në një nga kutitë e verdha për "Ankesat për Autoritetin e Zbatimit të Ligjit për Imigracionin".

Këto kuti janë vendosur në të gjitha IRC-të, STHF-të dhe dhomat e ndalimit dhe ato kontrollohen çdo ditë. Formularët e plotësuar gjatë udhëtimit të shoqërimit duhet t'i dorëzohen një anëtar të personelit, i cili do t'ia dërgojë ato Zyrës së Brendshme.

Ju gjithashtu mund ta dërgoni formularin direkt në adresën:

DetentionServicesComplaints@homeoffice.gov.uk

ÇFARË NDODH MË PAS?



Në rast se nuk jeni të kënaqur me rezultatin e hetimit, ju keni mundësinë ta dërgoni ankesën tuaj tek Ekzaminuesi i Pavarur i Ankesave (IEC) brenda tre muajve nga data e rezultatit të ankesës; informacioni i plotë do të jepet në letrën e përgjigjes përfundimtare.

Përndryshe, nëse nuk jeni të kënaqur me përgjigjet e dhëna, ose nëse çështja ka të bëjë me një Shkelje të Rëndë, atëherë ju keni të drejtë ta referoni ankesën tuaj tek Avokati i Popullit për Burgjet dhe Provën (PPO), i cili është i pavarur nga Zyra e Brendshme. Së bashku me përgjigjen përfundimtare, do t'ju jepet një kopje e fletëpalosjes së PPO-së Avokati 'Si të bëni një ankesë Tek Avokati i Popullit'.

As IEC [Ekzaminuesi i Pavarur i Ankesave] dhe as PPO [Avokati i Popullit për Burgjet dhe Provën] nuk mund të hetojë mbi çështjet që kanë të bëjnë me statusin tuaj të imigracionit, vendimin për ndalimin tuaj ose vendimin për t'ju larguar nga Mbretëria e Bashkuar. Zakonisht, ata procedojnë me hetimin vetëm pasi të jetë lëshuar letra e përgjigjes përfundimtare.

**JU LUTEMI MBANI FAQET 1 & 2 TË KËTIJ FORMULARI PËR INFORMACION DHE
HIDHNI NË KUTINË E ANKESAVE FAQET 3 & 4**

Emri / Mbiemri:	Emri (Emrat):
Data e Lindjes (dd/mm/vv):	Kombësia:
Referenca e Personit për Pajtueshmërinë dhe Zbatimin (CEPR):	Numri i Referencës i Zyrës së Brendshme:

Të dhënat e Kontaktit: Në rast se largoheni nga qendra e ndalimit përpara se të merrni një përgjigje, ju lutemi jepni një numër telefoni dhe një adresë emaili, në mënyrë që t'ju kontaktojmë:

Numri i telefonit:

Email:

Vendndodhja aktuale (IRC, STHF ose emërtim Tjetër)

Brook House IRC	☐	Campsfield IRC	☐	Colnbrook IRC	☐	Derwentside IRC	☐
Dungavel House IRC	☐	Harmondsworth IRC	☐	Haslar IRC	☐	Tinsley Hse IRC	☐
Yarl's Wood IRC	☐	Larne House STHF	☐	Manchester STHF	☐	Swinderby STHF	☐
Gjatë Eskortës	☐	Dhoma e Pritjes	☐				

Lokacioni ku ka ndodhur ngjarja për të cilën po ankoheni

Brook House IRC	☐	Campsfield IRC	☐	Colnbrook IRC	☐	Derwentside IRC	☐
Dungavel House IRC	☐	Harmondsworth IRC	☐	Haslar IRC	☐	Tinsley Hse IRC	☐
Yarl's Wood IRC	☐	Larne House STHF	☐	Manchester STHF	☐	Swinderby STHF	☐
Gjatë Eskortës	☐	Dhoma e Pritjes	☐				

	PO	JO
A është kjo një ankesë në lidhje me shërbimet e kujdesit shëndetësor apo personelin e tyre?		
Në rast se ankesa juaj ka lidhje me një incident gjatë të cilit ju jeni lënduar, personeli që kryen hetimin, përfshirë oficerët Hetues dhe Ndihmës Hetues të Njesisë së Standardeve Profesionale nga Zyra e Brendshme mund të duan të shqyrtojnë të dhënat tuaja mjekësore. A jeni dakord që të dhënat tuaja mjekësore të ndahen për këtë qëllim?		
A është ankesa juaj për sjelljen e personelit të Qendrës, Eskortës apo të Zyrës së Brendshme?		

Ankesa juaj do të ndahet me Bordin e Pavarur të Monitorimit (BPM), i cili, ashtu si Zyra e Brendshme, i përpunon këto të dhëna në mbështetje të bazës ligjore "detyrë publike". Nëse ankesa juaj përmban të dhëna të kategorisë së posaçme, ajo do të përpunohet sipas kushteve përkatës të "interetit publik të konsiderueshëm" në ligjin për mbrojtjen e të dhënave. Kjo do të thotë se Zyra e Brendshme dhe IMB i përdorin të dhëna tuaja për të kryer detyrat e tyre zyrtare. Nëse ankesa juaj përmban informacione të ndjeshme, siç është informacioni mbi shëndetin ose të dhënat mjekësore, ai do të përpunohet në mënyrë të sigurt dhe do të përdoret vetëm aty ku e lejon ligji për arsye të rëndësishme të interesit publik.

Ju lutemi jepni sa më shumë informacion që të jetë e mundur për të ndihmuar në hetimin e ankesës tuaj. Informacioni mund të përfshijë gjëra të tilla si emrat e palëve të përfshira, orët, vendndodhjen e detajuar etj.

Data e incidentit (dd / mm / vv):

Të dhëna për ankesën tuaj:

Firma:

Data kur është ngritur ankesa:

TANI, JU LUTEMI HIDHNI FAQET 3 & 4 TË FORMULARIT TUAJ TË PLOTËSUAR NË KUTINË E VERDHË TË ANKESAVE PËR AUTORITETIN E ZBATIMIT TË LIGJIT PËR IMIGRACIONIN PRANË ZYRËS SË BRENDSHME